

Skuadrat tona

Në çdo strukturë, fëmijët priten nga një skuadër edukative profesionale.

Skuadra edukative mbështet dhe inkurajon...

- PJSËMARRJEN E FËMIJËVE

Fëmijët shprehin idetë e tyre dhe krijojnë aktivitetet e tyre, me mbështetjen e të rriturve.

- E DREJTA PËR TË QENË I NDRYSHËM

Të rriturit i shoqërojnë fëmijët në pranimin e të qenit i ndryshëm, me qëllim që secila dhe secili të gjejë vendin e vërtetë në grup.

- KËNAQËSINË PËR TË QENË BASHKË

Fëmijët zënë miq dhe mike, mësojnë të njohin njëri tjetrin dhe të ndajnë interesat dhe dëshirat e tyre.

- BESIMIN

Të rriturit kanë besim në kapacitetet e fëmijëve, gjë që u lejon të krijojnë lidhje të forta dhe të përjetojnë përvoja në një mjedis të qetë.

www.lausanne.ch/apems

Shërbimi i shkollave dhe ai jashtëshkollor

Drejtoria e fëmijërisë,
e rinisë dhe e lagjeve
Place Chauderon 9 – 1003 Lausanne
021 315 64 11

→ REGJISTRIMET



Ville de Lausanne

Shërbimi i shkollave
dhe ai jashtëshkollor

Pritja jashtëshkollore 1-6P
(APEMS)



Shkurt...

→ *APEMS-ja (pritja për fëmijët në mjedis shkollor)* pret fëmijët nga 1P-ja në 6P para mësimit, gjatë pushimit të mesditës dhe pas mësimit.

Një hapësirë për...

→ Të luajtur, për të gjetur vetveten, për të marrë frymë, për të vendosur e për të përfituar nga koha e lirë, për të krijuar lidhje

Ku ndodhet ?

Pranë shkollave dhe në zemër të lagjeve, janë rreth 70 pika ku priten fëmijët.

Kush mund të përfitojë ?

Vendet parashikohen së pari për fëmijët prindërit e të cilëve punojnë, ndjekin një formim apo janë në kërkim të një pune (të regjistruar në ORP).



KUR SHKOHET ATJE ?

..... MËNGJES
07.00 - 08.30

..... MESDITË
11.50 - 13.50

..... PAS SHKOLLËS
15.30 - 18.30

... TË MËRKURËN PASDITE ...
11.50 - 18.30

*Mbyllur gjatë
pushimeve shkollore
(veç disa përjashtimeve)*

Çfarë bëhet atje ?

Luajnë e çlodhen !



Liri për të kaluar kohën duke luajtur, lëvizur e bërë një pushim të vogël.

Të mërkurën dhe pasditeve, propozohen aktivitete argëtuese ose kulturore.

Fëmijët mund të propozojnë projekte sipas interesave të tyre.

Të rriturit kujdesen për një mjedis të mirë dhe respektimin e të gjithave dhe të gjithëve.

Hanë !



Fëmijët hanë vakte të baraspeshuar dhe mund të zbulojnë shumëllojshmërinë e ushqimeve.

Mund të bëjnë edhe detyrat !



Me kërkesën e prindërve, fëmijët mund të bëjnë edhe detyrat, nën përkujdesjen e skuadrës edukative (DAC).